



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për Buxhet dhe Financa**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 41/09**

**Prishtinë, më 19.01.2009, ora 11:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203**

**PROCESVERBAL**

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

**Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Gani Koci, Haki Shatri, Besa Gaxherri, Myrvete Pantina, Shkumbin Demaliaj, Müfera Şinik, Xhevdet Neziraj, Hajdin Abazi, Riza Smaka, Naser Osmani.**

**Anëtarët jo të pranishëm: Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Teki Shala, Shefki Kastrati nga NDI, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.

**Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e 1, 2, 5, 9, 10, 15, 16, 17 dhe 18 dhjetor 2008**
- 3. Shqyrtimi i Draft-Raportit të punës së Komisionit për vitin 2008**
- 4. Përcaktimi i prioriteteve të punës së Komisionit për tremujorin e parë të vitit 2009**
- 5. Shqyrtimi i kërkesës nr. III-09 së Komisionit Kosovar të Konkurrencës për aprovimin e lartësisë së pagave të anëtarëve të këtij Komisioni**
- 6. Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/1465 Do-868 së Komisionit për Legjislacion dhe Gjqësi për vlerësimin e implikimeve buxhetore të Projekt - Rezolutës kundër krimeve të komunizmit në Kosovë**
- 7. Të ndryshme**

**Kryesuesi**, përshëndeti anëtarët duke iu uruar për punë të mbarë në sesionin e ri pranveror. Arsyetoi mungesën e deputetes Safete Hadërgjonaj. Njoftoi anëtarët se përveç pikave të paraqitura të rendit të ditës, ka pranuar një kërkesë nga Kuvendi dhe një tjetër nga Zyra e Rregullatorit për Ujë de Mbeturina, propozoi që të njëjtat të jenë pjesë e rendit të ditës. Më pas hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendit ditës miratohet me plotësime.

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e 1, 2, 5, 9, 10, 15, 16, 17 dhe 18 dhjetor 2008**

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të deklarohen për procesverbalet, për vërejtjet eventuale që mund ti kenë.

**Riza Smaka**, propozoi të bëhen dy ndryshime në procesverbal. Kërkoi që aty ku shkruhet kryetari i komisionit, pas kësaj fjale të shkruhet edhe emri i tij. Gjithashtu në fund të procesverbalit përpos fjalës njësia e komisioneve parlamentare të shkruhet edhe emri i personit që e ka hartuar procesverbalin.

**Besa Gaxherri**, kërkoi që në procesverbalin e dt. 17.12.2008, në pikën e dytë të rendit të ditës, në diskutimin e saj lidhur me ndërtimin e sheshi “Isa Boletini”, të zgjerohet diskutimi dhe të përfshihen më gjerësisht mendimet e saja që i ka shprehur lidhur me çështjen në fjalë.

**Kryesuesi**, konstatoi se procesverbalet nga mbledhjet e 1, 2, 5, 9, 10, 15, 16, 17 dhe 18 dhjetor 2008 miratohen me vërejtjet e bëra.

### **3. Shqyrtimi i Draft-Raportit të punës së Komisionit për vitin 2008**

**Kryesuesi**, theksoi se Draft Raporti për punën e Komisionit për vitin 2008 përfshin një përmbledhje të punëve dhe aktiviteteve që ka pasur Komisioni gjatë vitit të kaluar. Më pas kërkoi nga anëtarët të shprehin opinionin, propozimet e tyre për mundësin e plotësimit apo ndryshimit të këtij raporti.

**Riza Smaka**, theksoi se në pjesën e dytë – Fushëveprimtaria e Komisionit, aty ku është shkruar shqyrtimi i çështjeve buxhetore, të plotësohet në këtë formë, përcaktimi dhe shqyrtimi i çështjeve buxhetore, për arsye se Komisioni përveç që shqyrton çështjet, paraprakisht i përcakton ato.

**Myrvete Pantina**, duke komentuar raportin, theksoi se duke pasur parasysh faktin se Komisioni ka hartuar planin vjetor të punës, është më rëndësi të ceket se sa është realizuar ky plan, në këtë formë edhe shihen rezultatet që ka arritur komisioni.

**Kryesuesi**, duke iu përgjigjur parafolëses, theksoi se plani vjetor i punës së komisionit ka qenë orientues, përndryshe duke ditur natyrën e punëve që kryen ky komision, aktivitetet e Komisionit varen nga çështjet që parashtrihen për shqyrtim. Megjithatë nëse analizojmë mbledhjet që kemi mbajtur, shifet se plani është tejkaluar.

**Haki Shatri**, u pajtua me mendimin e kryesuesit se planin e kemi përmbushur njëqind për qind dhe nuk kemi lënë asnjë çështje që është parashtruar në Komision për shqyrtim pa përfunduar. Kërkoi që raportin ta përkrahin me mundësi të plotësimit dhe ndryshimit të tij me vërejtjet që mund të paraqesin anëtarët.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## **P Ë R F U N D I M**

- I. Miratohen raporti i punës së Komisionit për vitin 2008, me mundësinë e plotësimit dhe ndryshimit të tij deri në mbledhjen e radhës, me vërejtjet të paraqitura me shkrim nga anëtarët e Komisionit.

### **4. Përcaktimi i prioriteteve të punës së Komisionit për tremujorin e parë të vitit 2009**

**Kryesuesi**, njoftoi se kjo në këtë pikë ka menduar që të diskutohet për përcaktimin e prioriteteve për tre mujorin e parë të punës së Komisionit për këtë vit dhe se të njëjtat prioritete të paraqiten me shkrim. Kërkoj që prioritetet t'iu ipet shqyrtimit të Projektligjeve që janë në procedurë, në të cilat Komisioni është në cilësinë e komisionit funksional. Të tilla Projektligje janë: Projektligji për partneritetet publiko-private, Projektligji për Lizingun dhe Projektligji për Auditimin e Brendshëm. Sa i përket projektligjit të parë është formuar grupi punues në përbërje të: Gani Kocit, Riza Smaka dhe asistencës që do të ofrojnë përfaqësuesit e USAID-it. Kërkoj që të formohen edhe grupet e punës edhe për dy projektligjet tjera. Për shqyrtimin e Projektligjit për Lizingun Financiar propozoi që anëtar të grupit punues të jenë: Naser Osmani, Besa Gaxherri, Myrvete Pantina dhe Xhevdet Neziraj. Ndërsa anëtarë të grupit punues për shqyrtimin e Projektligjit për Auditimin e Brendshëm të jenë: Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina dhe Hajdin Abazi. Kryetari theksoi se këtyre grupeve punuese mund të i'u bashkëngjiten edhe anëtarët tjerë të interesuar.

Pas këtyre propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri mori këtë:

## **V E N D I M**

- I. Krijohen dy grupe punuese brenda Komisionit për Buxhet dhe Financa për të shqyrtuar dhe amendamentuar Projektligjin për Lizingun Financiar dhe Projektligjin për Auditimin e Brendshëm.
- II. Obligohen grupet punuese të paraqesin raportin me amendamente të cilat do të shqyrtohen dhe miratohen nga Komisioni.

Anëtarët e grupit punues për Projektligjin për Lizingun Financiar janë: Naser Osmani (raportues), Besa Gaxherri, Myrvete Pantina dhe Xhevdet Neziraj.

Anëtarët e grupit punues për Projektligjin për Auditimin e Brendshëm janë: Safete Hadërgjonaj (raportuese), Myrvete Pantina dhe Hajdin Abazi.

### **5. Shqyrtimi i kërkesës nr. III-09 së Komisionit Kosovar të Konkurrencës për aprovimin e lartësisë së pagave të anëtarëve të këtij Komisioni**

**Kryesuesi**, njoftoi se kemi të bëjmë agjencionin e pavarur, buxheti i së cilit është përfshirë në kuadër të buxhetit të përgjithshëm. Kërkesa e tyre ka të bëjë me faktin se po kanë probleme në ekzekutimin e buxhetit të tyre nga Ministria e Shërbimeve Publike. Prandaj kërkoj që Komisioni të nxjerr një rekomandim dhe të kërkoj nga MEF-i dhe MSHP-ja që të ekzekutojnë buxhetin e këtij agjencioni, konform statusit ligjor dhe ashtu siç është përfshirë buxheti i tij në kuadër të buxhetit të miratuar të Kosovës për vitin 2009. Një rast i tillë është edhe kërkesa e Zyrës së Rregullatorit

për Ujë dhe Mbeturina që kanë të njëjtin problem me ekzekutimin e buxhetit. Prandaj propozoi që të nxjerret një rekomandim i cili do shërbej si model edhe për agjencionet tjera të pavarura që kanë problem me ekzekutimin e buxhetit të tyre.

**Naser Osmani**, duke pasur parasysh faktin se ky Komision punon me orar jo të rregullt të punës, theksoi se për punën e tyre do të duhej të shpërbleheshin për pjesëmarrje në mbledhje e jo me paga të rregullta. Përndryshe kërkesa e tyre, tregon se kanë propozuar paga më të larta se deputeti apo zv. ministri.

**Hajdin Abazi**, u pajtua me mendimet e kryetarit që Komisioni me rekomandim të thirrëmi në vendimet që ka marrë për këtë agjencion rastin e miratimit të Buxhetit të Kosovës për vitin 2009.

**Haki Shatri**, theksoi se do të duhej në rekomandimin tonë për këtë komision të ceket se anëtarët e bordit e kanë pagan në nivelin e sekretarit permanent të Kuvendit duke i përfshirë edhe shtesat, ashtu siç jemi pajtuar gjatë shqyrtimit dhe miratimit të kërkesës së këtij Komisioni.

**Shkumbin Demaliaj**, duke pasur informacionet se Projektligji për Shërbyesit Civil është në procedurë, dhe duke ditur se ky Komisioni është organi i Kuvendit, propozoi që pagat e tyre të mbeten të ngjashme me agjencionet tjera të pavarura që i përgjigjen Kuvendit.

**Teki Shala, ekspert nga NDI**, theksoi se një problem i ngjajshëm i ekzekutimit të buxhetit qëndron edhe me agjencionet tjera të pavarura, prandaj është e domosdoshme të zgjidhet ky problem duke iu referuar Buxhetit të Kosovës për vitin 2009, pjesë e së cilit janë edhe shumëat buxhetore të këtyre agjencioneve.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

- I. Të përgatiten rekomandimet e veçanta për agjencionet e pavarura për mënyrën e ekzekutimit të buxhetit të tyre duke iu referuar Buxhetit të Kosovës për vitin 2009, pjesë e së cilit janë edhe shumëat buxhetore të këtyre agjencioneve.
  
6. **Shqyrtimi i kërkesës nr. 03/1465 Do-868 së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për vlerësimin e implikimeve buxhetore të Projekt-Rezolutës kundër krimeve të komunizmit në Kosovë**

**Kryesuesi**, theksoi se në parim rezoluta nuk përmban implikime buxhetore për shkak të karakterit jo detyrues të rezolutave. Mirëpo nëse derivon ndonjë ligj i cili bazohet në përmbajtjen e kësaj rezolute atëherë do të duhej të vlerësoheshin implikimet financiare që mund t'i shkakton ai ligj.

**Hajdin Abazi**, theksoi se pika e tretë e rezolutës hap rastin për mundësin e implikimeve buxhetore. Kjo ndoshta është arsyeja pse është kërkuar që bëhet vlerësimi i implikimeve buxhetore të saj.

Pas vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

- I. Komisioni vlerësoi se Projekt - Rezoluta kundër krimeve të komunizmit në Kosovë nuk përmban implikime buxhetore.

## 7. Të ndryshme

**Kryesuesi**, kërkoi që të nxjerret një rekomandim për zbatimin e buxhetit të Kuvendit të Kosovës në kategorinë paga dhe mëditje, ashtu siç është përfshirë në Buxhetin e Kosovës për vitin 2009. Njëkohësisht propozoi të rekomandohet që mënyra e shpërndarjes së mjeteve buxhetore të partive politike, të bëhet sipas kriterëve të vitit të kaluar.

Pasiqë nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

### **P r o p o z i m - R e k o m a n d i m**

- II. Të implementohet Buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, në linjën buxhetore paga dhe mëditje sipas kufijve buxhetor të përfshira dhe miratuara në Buxhetin në Republikës së Kosovës për vitin 2009
- III. Buxheti i Fondit për mbështetjen e demokratizimit – Mbështetje për partitë politike i përfshirë brenda kornizave të buxhetit të Kuvendit si linjë e veçantë buxhetore, të shpërndahet sipas kriterëve të përcaktuara në vitin 2008.

**Kryesuesi**, kërkoi nga anëtarët të caktojnë një ditë të rregullt për mbajtjen e mbledhjeve dhe varësisht prej aktiviteteve të ndryshohet ajo. Propozoi që mbledhjet e rregullta të Komisionit të mbahen ditën e hënë në orën 11:00.

Propozimi i kryesuesit u përkrah unanimisht.

**Kryesuesi**, njoftoi se me datën 21-24 do të jetë në një vizitë pune në Sllovaki, të cilën vizitë e ka organizuar NDI. Prandaj përgjegjësitë për aktivitetet e komisionit iu bartën nënkryetarëve të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në ora 12:15

**Përgatitur nga**  
**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit,**

---

**Gani KOCI**